



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezi

DATE/A:	18.12.2023
PËR:	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunes
NGA:	Saranda Stublla, Drejtor i DPKGJ-së
TEMA:	Raport pune për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2023
Nr.Pro:	08-334/06-0087978/23

1. **PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës:

- Drejtoria për pronë, kadastrë dhe gjeodezi konkretisht zyra kadastrale komunale (ZKK) e Podujevës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetar duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.
- Gjatë periudhës kohore Janar 2023 – Dhjetor 2023 pran sektorit për Pronë, Kadastrë dhe Gjeodezi janë pranuar gjithsejtë 11,689 kërkesa të ndryshme për shqyrtim.
- Në sektorin për Kadastrë dhe Gjeodezi janë pranuar gjithësejt 11,290 kërkesa apo 96.6% e të gjitha kërkesave për shqyrtim janë pranë këtij sektori ku janë aprovuar 11,106 sosh, prej tyre kanë mbetur në procedurë edhe 184 kërkesa, pra mund të themi se 98.4% e të gjitha kërkesave të pranuar pran pran sektorit për KGJ janë aprovuar dhe kanë marrë përgjigje meritore.

2. **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA NË SEKTORIN E KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

- 2718 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronësisë sipas Aktvendimeve mbi shqyrtimin e Trashëgimisë, Kontratave mbi shërbimet apo Dhurimin e paluajtshmërive, ndarje, bashkim, përcaktim dhe ri-rregullim të njësive kadastrale, ku prej tyre janë aprovuar 2547 sosh apo thënë në % janë aprovuar 93.7%, po ashtu janë refuzuar 13 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 3 aktvendime për pezullim të përkohshëm të procedurës deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse.
- 34 kërkesa për historiat të ngastrës, nga persona fizik dhe juridik që të gjitha janë aprovuar.
- 48 kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe 44 kërkesa për çregjistrim të hipoteke prej të cilave janë aprovuar të gjitha
- 105 përmirësime të çertifikatave të pronësis dhe aktvendimeve të ndryshme prej të cilave janë aprovuar 102 sosh
- 7 kërkesa për shënimin e barrës tatimore mbi paluajtshmërinë dhe 1 lirim i barrës tatimore prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
- 7 kërkesa për shënimin e masës së sigurisë mbi paluajtshmërinë dhe 2 lirime të masës së sigurisë mbi paluajtshmërinë prej cilave janë aprovuar që të gjitha
- 8,127 kërkesa për lëshimin e çertifikatave të pronësisë, kopje të planit, koordinata për njësi, vërtetim që pala nuk posedon paluajtshmëri prej të cilave janë aprovuar që të gjitha.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA NË SEKTORIN E PRONËS

- Gjatë periudhës kohore **Janar 2023 – Dhjetor 2023** pranë sektorit për **Pronë** janë shqyrtuar gjithësejt 399 kërkesa të ndryshme që të gjitha janë shqyrtuar dhe kanë marrë vendime dhe përgjegjje meritore si:
 - 2 kërkesa të uzurpimeve të pronës komunale prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
 - 3 Aktvendime të uzurpimeve sipas detyrës zyrtare
 - 205 shkresa dërguara organeve tjera
 - 60 Njoftime për përmbarrim
 - 15 kërkesa për shëndërrim të pronës private në pronë Komunale me destinim të rrugës
Prej të cilave janë aprovuar që të gjitha.
 - 20 kërkesa për dhënie të kopjes së Aktvendimit të vjetër prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
 - 1 Shkëputje të Kontratës mbi qiran
 - 4 Lidhje të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale (Lokale afariste)
 - 72 Njoftime për pagesë të qirasë
 - 18 kërkesa për shitblerjen e Banesave për të cilat ka ekzistuar e drejta banesore ku prej tyre janë refuzuar 4 kërkesa
 - 3 kërkesa drejtuar AKP-së
 - 11 lidhje të kontratave mbi shitblerjen e banesave për të cilat ka ekzistuar e drejta banesore
 - Shpronësimi i pronave të Kooperativës Bujqësore – Podujevë në ZK: Livadiçë, Surkish dhe Obrangjë me sipërfaqe prej 457,292.41 m² të cilat kalojnë në pronë të Komunës së Podujevës.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Nga sektori i pronës, kadastrit dhe gjeodezis aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët në shpallje publike që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatun kadastral.
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave.
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

Vërejtje: Raporti përmban të dhëna nga data 04.01.2023 deri më datën 15.12.2023